



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 763/1 prot.

Tiranë më 4.4.2022

Lënda: Dhënie mendimi mbi projektvendimin

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 1968/1 prot., datë 07.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 763 prot., datë 11.04.2022, përmes së cilës dërgohet për mendim projektvendimi “Për miratimin e rregullave të detajuara për të dhënat parësore dhe dytësore, rregullat për ndërveprimin me bazat e tjera të të dhënave shtetërore, si dhe nivelin e aksesimit të regjistrin elektronik të gjendjes gjyqësore të shtetasve të dënuar jashtë vendit, por me banim të përhershëm në shtetin Shqiptar”, më poshtë gjeni vlerësimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nga shqyrtimi i projektvendimit dhe relacionit shoqërues, vlerësojmë se, ndryshimet të cilat duhet të reflektohen në projektvendimin në fjalë, janë si vijon:

Në Kreun I, Dispozitat e Përgjithshme, sugjerojmë që, të përfshihet një pikë më vete lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, sipas kësaj përmbajtje: “Përpunimi i të dhënave personale në regjistrin elektronik të shtetasve të dënuar jashtë vendit, duhet të kryhet në përputhje me parimet dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Më tej, në pikën 12 të kreut III, të projektvendimit, e cila parashikon nivelin e aksesit në sistem dhe bazën e të dhënave të regjistrit elektronik, duhet të përfshihet gjithashtu një pikë e cila të përmbajë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, që duhet të garantojnë subjektet që do të kenë akses në këtë regjistër.

Me përfshirjen e sugjerimeve të sipërpërmendura, projektvendimi vlerësohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,



KOMISIONERI

Besnik Dervishi